



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 144

Tiranë – E enjte, 16 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 31.8.2021	Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”..... 13819
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 31.8.2021	Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 16.8.2021, “Për vitin shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar”..... 13821
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 375, datë 30.8.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar..... 13821
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 180, datë 1.9.2021	Mbi treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021..... 13822
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 13, datë 27.8.2021	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 13824
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 180/10, datë 14.9.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës ‘Sabri Kosturi’, Lushnjë”..... 13825



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 18, datë 31.8.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 18,
DATË 1.7.2020, “PËR PROCEDURAT E
PËRDORIMIT TË FONDEVE TË
BUXHETIT TË SHTETIT PËR
BOTIMIN, SHTYPJEN,
SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E
TEKSTEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar; dhe të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

- a) Në kreun III, bëhen këto ndryshime:
i. Pika 3, ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Shtëpitë botuese/distributorët duhet të lëshojnë për zyrën vendore të arsimit parauniversitar përkatëse, faturën tatimore të shitjes, sipas legjislacionit në fuqi, për sasinë e teksteve shkollore të shitura pjesë e katalogut, sipas porosisë së kryer nga çdo institucion arsimor i sistemit parauniversitar, pasi të kenë rakorduar me këto të fundit për të gjitha kategoritë që përfitojnë tekste shkollore falas.”.

ii. Në pikën 6, togfjalëshi “të klasave VIII dhe IX dhe arsimin e mesëm të lartë” zëvendësohet me togfjalëshin “të arsimit të mesëm të lartë.”.

b) Pas pikës 3, të kreut IV, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Përfshihet, për vitin shkollos 2021–2022, afatet e kërkesave nga institucionet arsimore dhe ZVAP-të, paraqiten brenda datës 15.9.2021.”.

c) Formulari nr. 1 zëvendësohet me formularin me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



Formular nr. 1

Kërkesë e shkollës _____ drejtuar ZVAP-së, për mbështetje me fonde buxhetore për shtëpitë botuese/distributorët në “arsimin bazë”

Nr.	Emri, mbiemri i nxënësit/prindërit	Emri/shkolla	Klasa 1-9	Statusi i përfitimit, sipas pikës 6, të VKM-së, mbështetur në vendimet e njësisë së pushtetit vendor	Fatura nr. , datë e shtëpisë botuese	Nr. i NIPT-it të shtëpisë botuese “Drita”, “Dielli”, “Hëna” etj.	Sasia e teksteve të blera/copë	Vlera e teksteve, në lek (shuma që konfirmohet prind/nxënësi, në lek)	Nr. dokumenti i identitetit për prindin që konfirmon marrjen/pajisjen me tekste shkollore nga prindi/në emër të nxënësit	Emri, mbiemri, nënshkrimi për prindin që konfirmon pajisjen me tekste shkollore të fëmijës/nxënësit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ermal Dritan Peto	Delvinë	I	Pikës “a”	Nr. 15, datë 1.9.2018	J21424005 U	5	2.800	Plotësohet ditën kur tërhiqen tekstet shkollore	Plotësohet datën kur tërhiqen tekstet në klasë/shkollë
2	Denisa Paskal Naçe	Delvinë	I	Pikës “b”	Nr. 15, datë 1.9.2018		5	2.800		
		Delvinë	I	etj.						
25	Orion Sokol Vrapit	Delvinë	I		Nr. 8, datë 2.9.2018		5	2.500		
					TOTALI			8.100		



UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 19, datë 31.8.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
E PËRBASHKËT NR. 17, DATË 16.8.2021,
“PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022 NË
SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 16.8.2021, “Për vitin shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Pika 3, e kreut I/I.2, ndryshon si më poshtë:

“3. Zbatimin e udhëzuesve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët për përsëritjen e temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi, për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 1–24 shtator 2021.”

b) Pika 2, e kreut I/I.3.1, ndryshon si më poshtë:

“2. Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit me prindërit dhe komunitetin, për krijimin e një modeli të ri të sjelljes së nxënësve, mësuesve dhe prindërve në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, bazuar në protokollet e situatës së COVID-19. Zbatimin e udhëzuesit të ASCAP-it për arsimin e mesëm të lartë për përsëritjen e temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi, për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 1–24 shtator 2021.”

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e

Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 375, datë 30.8.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.
633, DATË 17.11.2020, “PËR NDALIMIN E
GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË
MBYLLURA APO TË HAPURA”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 6.9.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 20.9.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



VENDIM
Nr. 180, datë 1.9.2021

**MBI TREGUESIT PËR KRITERET
STANDARDE TË CILËSISË SË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT DHE
PERFORMANCËS SË SIGURISË SË
RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
97, DATË 7.4.2021**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 91, 92 dhe 104, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 16/1 prot., datë 30.8.2021, të drejtorive teknike, “Mbi treguesit dhe kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021”,

konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, miratoi “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, Bordi i ERE-s vendosi:

1. Të miratojë treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes.

2. Të pezullohet zbatimi i pikës 7.2, të nenit 7, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, për një afat deri

më 31 gusht 2021, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Efektet juridike të pikës 7.2 të rregullores së sipërcituar do të fillojnë në datën 1 shtator 2021.

3. OSSH sh.a. të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj mbi ecurinë e zbatimit të treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes për vitin 2021.

4. Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes do të jenë objekt i rishikimit, konsultimit dhe miratimit me iniciativën e ERE-s ose me propozimin e OSSH sh.a., dhe çdo pale interesi.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) nëpërmjet shkresës nr. 8642 prot., datë 2.8.2021, protokolluar në ERE me nr. 874, datë 4.8.2021, me lëndë “Mbi Treguesit për kriteret standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021”, parashtroi një ecuri të zbatimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021.

- Në shkresën e sipërcituar, OSSH sh.a. ka bërë, gjithashtu, me dije se ka vijuar të kryejë regjistrimin e ndërprerjeve të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon, përmes sistemit të regjistrimit manual të vazhdueshmërisë së shërbimit, duke funksionuar për të gjitha linjat TL, TM dhe TU të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe mban regjistrin e ndërprerjeve, i cili përmban:

- a) origjinën e ndërprerjes;
- b) shkakun e ndërprerjes;
- c) numrin e klientëve në TL të përfshirë në ndërprerje;
- d) kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje;
- e) numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- f) kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- g) numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;
- h) kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rildhjes, të ndarë sipas kategorive;
- i) datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët e përfshirë në ndërprerje;



j) çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe përdoret në llogaritjen e treguesve të performancës SAIDI, SAIFI, koha e nevojshme për riparimin e shërbimit pas një defekti, energjia e pafurnizuar.

- OSSH sh.a., në shkresën nr. 8642 prot., datë 2.8.2021, është shprehur se e vlerëson të domosdoshëm organizimin e një seance dëgjimore teknike mes përfaqësuesve të ERE-s dhe atyre të OSSH sh.a., për të diskutuar në mënyrë të detajuar lidhur me problematikat e paraqitura në këtë shkresë, diskutimin dhe ndarjen e mendimeve për të arritur në konkluzione të qarta, reale dhe të mundshme nga ana e shoqërisë për zbatim. E njëjta kërkesë e shoqërisë është rikërkuar edhe përmes *email*-it të datës 29 gusht 2021, të përcjellë në adresën: erealb@ere.gov.al.

- OSSH sh.a., në raportimet periodike të ecurisë së zbatimit të treguesve, por edhe në raportimin e bërë me shkresën nr. 8642 prot., datë 2.8.2021, ka përcjellë, gjithashtu, të dhëna dhe informacione të cilat duhet të konsultohen, duke përfshirë edhe palë të tjera të interesit, siç janë përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes.

- Bordi i ERE-s, duke marrë në konsideratë, se:

- pika 2, e vendimit nr. 97, datë 7.4.2021, pezullon zbatimin e pikës 7.2, të nenit 7, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, për një afat deri më 31 gusht 2021, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

- nevojën për një diskutim dhe konsultim më të gjerë ku të përfshihen dhe palët e interesit për sa parashtruar nga OSSH sh.a., në raportimet periodike, si dhe në shkresën nr. 8642 prot., datë 2.8.2021; dhe

- ndikimin e madh që kanë standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, si për operatorin e rrjetit dhe për përdoruesit e tij,

për analizimin e të gjitha elementeve të cituara më sipër, në mënyrë që të realizohet një proces konsultimi i drejtë, i saktë dhe shterues dhe me qëllim ezaurimin e procedurës administrative, si

dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative, të cilat parashikojnë se ndonëse, procedura administrative, e nisur përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91, për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete.

- Në këto kushte, Bordi i ERE-s vlerëson të nevojshëm zgjatjen e pezullimit të zbatimit të pikës 7.2, të nenit 7, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, deri në datën 14 tetor 2021, dhe efektet juridike të kësaj pike nisin më 15 tetor 2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 7.4.2021, duke përcaktuar, se: “Pezullimi i zbatimit të pikës 7.2, të nenit 7, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të vijojë deri në datën 14 tetor 2021. Efektet juridike të pikës 7.2, të rregullores së sipërcituar, fillojnë në datën 15 tetor 2021.

2. Ndryshimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi hyjnë në fuqi më 1 shtator 2021.

3. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Standardeve të njoftojë OSSH sh.a. dhe palët e interesit, në lidhje me vendimin e Bordit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego



VENDIM
Nr. 13, datë 27.8.2021

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 13, datë 27.8.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje objekti “Zgavra” nr. 4787, në ngarkim të **P.C.**, me 4 volume, me 1144 (një mijë e njëqind e dyzet e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

2. Dosje e problemit të centralizuar “Zgavra” nr. 1067, në ngarkim të **P.C.**, me 3 volume, me 671 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega IV.

3. Dosje formulare nr. 2902, në ngarkim të **S.Q.**, me 6 volume, me 1353 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

4. Dosje përpunimi nr. 2422, në ngarkim të **F.Q.**, me 6 volume, me 1557 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

5. Dosje formulare nr. 2905, në ngarkim të **Th.J.**, me 4 volume me 636 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

6. Dosje hetimore nr. 29, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1988. Dosja i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Kukës.

7. Regjistër agjente nr. 1, model 2, me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë, fillon me nr. rendor 26 dhe mbaron me numrin rendor 5422, në total janë 53 (pesëdhjetë e tre) fletë të plotësuar. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Sekret”. Regjistri i përket fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

8. Dosje personale dhe pune nr. 4874, në ngarkim të **D.M.**, me 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

9. Fotokopje kartelë model 2, nr. 2226, në ngarkim të **D.M.**, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret A.R.P.”. Kartela i përket fondit ish-Dega IV.

10. Fondi 4, Drejtoria I, dosje nr. 363, viti 1985. Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar repartit 313 për trajtimin me ushqim special të të arrestuarve. I.H., S.B., Sh.Ç., A.P. etj. Dosja ka 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Fashikull i problemit të centralizuar nr. 1080 “Debiti”, në ngarkim të **A.J.**, me 2 volume me 334 (treqind e tridhjetë e katër) fletë në total + 2 (dy) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega IV.

12. Dosje formulare nr. 274, në ngarkim të **A.J.**, me 3 volume me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Dega IV (Fondi rezervë).

KRYETAR I KOMISIONIT TË
DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula



KËRKESË
Nr. 180/10, datë 14.9.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ajencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës ‘Sabri Kosturi’, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në

Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5.020.078 (pesë milionë e njëzet mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
“SABRI KOSTURI” LUSHNJË

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja truallit m ²	Çmimi i truallit, lek/m ²	Vlera e truallit, lek	Sipërfaqja ndërtimi m ²	Çmimi ndërtimit, lek/m ²	Vlera e ndërtimit, lek	Vlera totale truall dhe ndërtimesh, lek=	Shënime
1	8572	24/11	Lushnjë	Ilirjan Niazi Lika	51	8,954	456,654	50		1,528,018	1,984,672	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
2	8572	24/18	Lushnjë	Andrea Aqif Kaja	8	8,954	71,632				71,632	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
3	8572	24/53	Lushnjë	Fildus Batiar Beqiri dhe bashkëpronarë	90	8,954	805,860				805,860	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 2240/1, datë 24.2.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
4	8572	10/35	Lushnjë	Jorgo Zari Manoku dhe bashkëpronarë	14	8,954	125,356				125,356	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
5	8572	14/210	Lushnjë	Niazi Beqir Liçi	75	8,954	671,550				671,550	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
6	8572	14/209	Lushnjë	Dashnor Beqir Liçi	76	8,954	680,504				680,504	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
7	8572	24/27	Lushnjë	Petrit Hajdar Muço dhe bashkëpronarë	10	8,954	89,540				89,540	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
8	8572	24/25	Lushnjë	Petrit Hajdar Muço dhe bashkëpronarë	12	8,954	107,448				107,448	Shkresa e ASHK-së DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekar datë 11.2.2021.
9	8572	24/56	Lushnjë	Jashar Arif Muço dhe bashkëpronarë	54	8,954	483,516				483,516	Shkresa e ZVRPP-së Lushnjë nr. 7791, datë 24.2.2019. Vërtetim hipotekar datë 17.12.2021.
										SHUMA	5,020,078	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë